



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA KORÇË**  
**DREJTORIA E KUJDESIT SOCIAL**

**RELACION**

***PËR MIRATIMIN E GRANTIT PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT***  
***“PËRFSHIRJE SOCIALE PËR NDRYSHIM” MIDIS BASHKISË KORÇË DHE***  
***PROGRAMIT TË KOMBEVE TË BASHKUARA PËR ZHVILLIM (UNDP)***

Në kuadër të Programit të Përbashkët të Kombeve të Bashkuara “Askush të Mos Mbetet Pas” Bashkia Korçë ka aplikuar me projektin me temë : “ Përfshirje sociale për ndryshim” dhe ka përfituar një grant prej 3,000,000 lekë. Kontributi i Bashkisë është kontribut në natyrë si burime njërezore qera sallë e përlogaritur në vlerën totale 649,000 lekë.

Në vijim të realizimit të marrëveshjes së Bashkëpunimit me Nr. 4818 Prot., datë 21.06.2023 midis Bashkisë Korçë dhe Programit Të Kombeve Të Bashkuara Për Zhvillim është çelur kësti i parë me vlerë totale 1,800,000 lekë, është miratuar në këshillin Bashkiak dhe është realizuar:

- krijimi i rrejtave locale të palëve të interesuara,- inicimi i një shërbimi të lëvizshëm për informimin dhe identifikimin e nevojave - trajnime për nënat dhe fëmijët dhe trajnime profesionale për të rinjtë për orientimin drejt kërkesave të tregut.

Në vijim të marrveshjes së sipërpërmendur është çelur kësti i dytë me shumën 1,200,000 lekë ( 40 % e vlerës totale të projektit) me synim realizimin e aktivitetit si më poshtë:

### **1- Realizimi i Kampit Veror Miqësia me vlerë totale 1,200,000 lekë.**

Ky objektiv synohet të realizohet nëpërmjet:

- Krijimit të një mjedisi gjithëpërfshirës, promovimit të miqësisë mes fëmijëve me aftësi ndryshe, në nevojë, situatë rruge, fëmijëve nga minoritetet dhe maxhoranca, ndërgjegjësimit për gjithëpërfshirjen dhe integrimin social.

-Realizimin e një sërë aktiviteteve edukative, rekreative dhe sociale që do të nxisin zhvillimin e aftësive të tyre sociale, njohëse dhe motorike. Këto aktivitete do të përfshijnë lojëra në grup, aktivitete artistike, sporte, ekskursione dhe punëtorë interaktive.

- Krijimi i një mjedisi ku fëmijët mund të kapërcejnë barrierat sociale dhe ekonomike dhe të zhvillojnë një ndjenjë komuniteti dhe solidariteti.

Gjatë gjithë aktiviteteve do të mundohet të ruhet balanca gjinore, por kjo nuk varet vetëm nga projekti por edhe nga target grupet që përshtaten me specifikën e aktiviteteve të tij.

Për të gjitha këto arsye, i kërkojmë Këshillit të Bashkisë miratimin e grantit prej 1,200,000 lekësh dhe përdorimin e tij si më poshtë dhe me këtë strukturë buxhetore:

Ushqim- 650,000 lekë ; Mësues- 250,000 lekë ; Mjete didaktike dhe argëtuese- 150,000 lekë  
Transport 150,000 lekë .

Programi Përkujdesi Social

SHTOHET A1122 PROD. V043AAI 00 Art. 6020000 05 + 1,200,000 lekë

Duke ju referuar ligjit nr. 139 /2015 “ Për vetqeverisjen Vendore , udhëzimit nr. 9 datë 20.03.2018 i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “ Për proceduar standarte të zbatimit të buxhetit” , ligjit 9936 “ Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 68 datë 27.04.2014 “ Për financat e Vetqeverisjes vendore”, i ndryshuar, ligjit Nr. 97/2023 “ Për buxhetin e vitit 2024”, Udhëzimit plotësues nr.1 date 24.01.2024 “ Për zbatimin e buxhetit te vitit 2024, VKB nr. 167 datë 29.12.2023 “Mbi miratimin e buxhetit të Bashkisë Korçë për vitin 2024” dhe PBA 2024-2026 të Bashkisë Korçë urdhrit nr 21 datë 15.1.2024 “Për detajimin e shpenzimeve korrente për vitin 2024 të Bashkisë dhe Institucioneve të Varësisë “ sipas programeve dhe produkteve, si dhe marrëveshjen e bashkëpunimit me Nr. 4818 Prot., datë 21.06.2023 midis Bashkisë Korçë dhe Programit Të Kombeve Të Bashkuara Për Zhvillim, kërkojmë të miratohet në Këshillin Bashkiak granti me vlerën 1,200,000 lekë dhe përdorimi i tij si më sipër.

*Drejtores e Përgjithshme e Drejtorisë Juridike dhe Burimeve Njerëzore*

*Drejtores e Kujdesit Social*

*Drejtores e Përgjithshme e*

*Financës, Buxhetit dhe*

*MFK*

**Anxhela Qeramixhi (Dishnica)**

**Mariana Jorgji**

**Valbona Ziko**

**KRYETARI I BASHKISË**

**Sotiraq Filo**